



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 238, datë 07.07.2020

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATAT E APELIT TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËN DHE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE
TË APELIT, PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMET E
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR TË DATËS 28.05.2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.173, nr.174, nr.176, nr.179, nr.180, nr.181, nr.182, nr.183, nr.184, nr.185, nr.186, nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

- | | |
|-------------------------------|-------------------------------|
| 1. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Alban Toro; |
| 2. Për kandidaten znj. {...} | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 3. Për kandidaten znj. {...} | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 4. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Alban Toro; |
| 5. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Ilir Toska; |
| 6. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Alban Toro; |
| 7. Për kandidatin z. {...} | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 8. Për kandidatin z. {...} | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 9. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Ilir Toska; |
| 10. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Alban Toro; |
| 11. Për kandidatin z. {...} | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 12. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Alban Toro; |
| 13. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Ilir Toska; |
| 14. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Ilir Toska; |
| 15. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Ilir Toska; |

- | | |
|-------------------------------|-------------------------------|
| 16. Për kandidaten znj. {...} | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 17. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Alban Toro; |
| 18. Për kandidaten znj. {...} | - relator znj. Marçela Shehu; |
| 19. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Alban Toro; |
| 20. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Ilir Toska. |

3. Për kandidatët znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}, të cilët kanë kandiduar edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm ose në Gjykatën Administrative të Apelit, respektivisht për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.179, nr.187 dhe nr.181 e nr.183, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.180, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion më datë 03.07.2020.

5. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr.176, datë 28.05.2020, si dhe për pozicionin e lirë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këto pozicione më datë 03.07.2020.

6. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion më datë 03.07.2020.

7. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 28.05.2020, për kandidatët znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, në kushtet e tërheqjes së tyre nga kandidimi për pozicionet përkatëse, respektivisht në datat 16.06.2020, 22.06.2020 dhe 03.07.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR